



K.DH.SH.II.nr.1526/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Faton Bajrami, kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Saranda Bogaj Sheremeti, anëtare të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Europrojekt Plus O.P” me seli në Mitrovicë, me numër unik identifikues 811328295, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson U.G., nga Mitrovica, kundër të paditurve Komuna e Mitrovicës, përfaqësuar nga I.Z., avokat nga Prishtina dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditësit ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.37/22 i datës 08.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 16.06.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuar ankesat e të paditurës, Komuna e Mitrovicës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor e datës 20.09.2023, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.37/22 i datës 08.05.2023, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin KA.nr.37/22 të datës 08.05.2023, Nën pikën I. të dispozitivit, është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit “Europrojekt Plus” O.P. Nën pikën II. Anulohet si absolutisht i pavlefshëm Konkluzioni nr. 8-28/12 i datës 11.05.2012 i nxjerrë nga i padituri i parë Komuna e Mitrovicës. Në pikën III. Ky aktgjykim e zëvendëson aktin e anuluar dhe ka karakter detyrues. Në pikën IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura Komuna e Mitrovicës dhe MMPH, ka ushtruar ankesë, me dt. 20.09.2023, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të; konstatimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së dispozitave të procedurës Ligjit për Konfliktet Administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Dhoma e Shkallës së Dytë të nxjerr aktvendim, I. Aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut me seli në Rrugën “Bedri

Gjinaj” Mitrovicë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Avokat I.Z. e parashtruar kundër aktgjykimit KA.nr.37/22 të datës 08.05.2023 i nxjerr nga Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, e pranuar nga e paditura me datë 04.09.2023 II. Të Anulohet aktgjykimi me numër KA.nr.37/22 i datës 08.05.2013 i nxjerrë nga Gjykata Komerciale dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Ose që Dhoma e Shkallës së Dytë të merr aktgjykim, I. Aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut me seli në Rrugën “Bedri Gjinaj” Mitrovicë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Avokat I.Z. e parashtruar kundër aktgjykimit KA.nr.37/22 të datës 08.05.2023 i nxjerr nga Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës së Parë, e pranuar nga e paditura me datë 04.09.2023. II. Hedhet poshtë si e palejuar padia e paditësit “Euro Projekt Plus” OP, me numër unik identifikues 811328295, me seli në rrugën “11 Marsi” p.n Mitrovicë, të cilin në bazë të autorizimit e përfaqëson avokat Ubejd Gashi me seli në Mitrovicë, e parashtruar ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës së Jugut me seli në rrugën “Bedri Gjinaj” Mitrovicë, të cilën në bazë të autorizimit e përfaqëson Avokat I.Z., për anulimin e Konkluzionit me numër të protokollit 08-28/12 të datës 11.05.2012.

Përgjigje në ankesë nuk është paraqitur.

Gjykata Komerciale, Dhoma e Shkallës së Parë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe vlerësimit komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, dhe 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të zbatueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka gjetur se:

Ankesat e të paditurve janë të pa-bazuara.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Konkluzionin me nr. prot 08-28/12 të datës 11.05.2012 në pikën I. Konstatohet se Ndërmarrja “Euro Projekt” nga Mitrovica nuk e ka kryer pagesën e pjesës së mbetur të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore në afat të pa përcaktuar, lidhur me ndërtimin e ndërtesës afariste- shumë banesor, me etazhitet (B+P+11), e ndërtuar në parcelat kadastrale Nr.1796, 1797/1 dhe 1797/2, në Rr. “11 Marsi 81” p.nr. në Mitrovicë në shumë prej 84,469.28€. në pikën II. Obligohet Investitori i ndërtesës “Euro Projekt” që shumën e kompensimit tarifor sipas pikës 1 të këtij konkluzioni ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit.

Kundër vendimit të Drejtorisë për Urbanizëm nga Mitrovica dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, paditësi inicion padi në konflikt administrativ. Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative në këtë çështje juridike administrative, më datë 28.04.2023, mban seancë të shqyrtimit kryesor në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e aprovon kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, dhe e anulon aktvendimin e organit të paditur, sipas konkludimeve të vërtetuara nga gjendja faktike, në arsyetim të aktgjykimit është theksuar se: Gjykata ka konstatuar se i padituri i parë Komuna e Mitrovicës, nuk ka nxjerrë konkluzion në përputhje me nenin 97 të LPA-së pasi që me konkluzion janë përcaktuar

obligime të cilat nuk është vendosur më parë me akt tjetër administrativ-vendim. Gjykata vlerësoi pretendimet e të paditurit të parë në përgjigje në padi se paditësi me rastin e aplikimit për rregullimin e tokës ndërtimore ka qenë i vedyshëm që detyrohet të paguaj kompensimin e tarifës për rregullimin e tokës ndërtimore në shumë të përgjithshme prej 104,469.28€ dhe për këtë qëllim paditësi ka paguar shumën prej 20,000€, por gjykata këtë pretendim të paditurit nuk e gjeti të bazuar pasi që nuk është dëshmuar me prova tjera që vërtetojnë faktin se paditësi ka aplikuar për rregullimin e tokës ndërtimore, apo që Komuna e Mitrovicës ka aprovuar kërkesën e paditësit për rregullimin e tokës ndërtimore si dhe me një akt administrativ i ka përcaktuar tarifën për rregullimin e tokës ndërtimore, andaj gjykata gjeti se akti i vetëm me të cilin paditësi është ngarkuar për pagesën e shumës prej 84,469.28€ është Konkluzion i kontestuar me këtë padi. Gjykata ka vlerësuar se i padituri i parë përmes konkluzionit kontestues nuk ka vendosur për çështjet që kanë të bëjnë me procesin dhe ato çështje të cilat shfaqen si dytësore lidhur me zbatimin e procesit e që nuk vendosen me aktvendim ashtu siç përcaktohet me nenin 97 të LPA-së por me konkluzion ka vendosur për çështjet të cilat vendosen me aktvendim veprim ky që ë bënë konkluzionin kontestues absolutisht të pavlefshëm pasi që akti është nxjerrë në kundërshtim me formën e kërkuar nga LPA ashtu siç përcaktohet me nenin 92 pika c) të LPA-së. Gjykata po ashtu ka vlerësuar edhe provën pasqyrë financiare lidhur me inkasimi e mjeteve në emër të kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore për ndërtimin e ndërtesës kolektive të cilat janë ndërtuar pa leje ndërtimi, në të cilat është përcaktuar shuma e paguar dhe shuma e mbetur për pagesë, por gjykata nga kjo provë nuk ka arritur të vërtetoj faktin nëse paraprakisht i padituri i parë ka nxjerrë akt administrativ për përcaktimin e shumës së kompensimit, gjithashtu gjykata nuk ka gjetur prova se palët kanë lidhur kontratë për pagesën e borxhit, nga ka rrjedhur borxhi dhe cilat kanë qenë kushtet për pagesën e borxhit. Gjykata ka vendosur për pikën II dhe III të dispozitivit të këtij aktgjykimi mbështetur në nenin 46 par.4 të LKA-së që përcaktojnë se “4.Kur gjykata konstaton se akti administrativ i kontestuar duhet të anulohet, mundet, nëse karakteri i çështjes e lejon dhe nëse të dhënat dhe faktet e administruara gjatë procedurës japin bazë të sigurt për këtë gjë, me aktgjykim të vendos për çështjen administrative. Aktgjykimin e zëvendëson aktin e anuluar.” Ashtu që gjykata e ka trajtuar çështjen me meritë dhe ka vendosur që të anuloi konkluzionin kontestues si absolutisht të pa vlefshëm. Gjykata duke pasur parasysh konstatimet e mësipërme në kuptim të nenit 43 par.3 dhe nenit 46 par. 4 të Ligjit për Konfliktet Administrative ka vërtetuar vetë gjendjen faktike dhe ka vendosur me aktgjykim çështjen administrative në mënyrë meritore pasi që të dhënat dhe provat e administruara gjatë procedurës kanë dhënë bazë të sigurt për të vendosur në mënyrë meritore.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata me rastin e vendosjes gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike pasi që lidhur me konkluzionin e lëshuar nga e paditura e parë, paditësi me datë 24.05.2012 ka njoftuar, përkatësisht ka paraqitur përgjigje ndaj konkluzionit me nr. prot. 08.031.29708, me të cilin vërtetohet se paditësi e ka pranuar obligimin në shumën prej 84,469.28€, mirëpo ka kërkuar që llogaritja e obligimit/detyrimit të paditësit të bëhet sipas rregullores së re për shkak se për objektin e ndërtuar nuk posedojnë leje ndërtimore dhe se i njëjti është në procedurë të legalizimit, gjykata e shkallës së parë nuk ka marrë për bazë përgjigjen në padi të paditësit në konkluzionin e paraqitur me datë 24.05.2012 pranë të paditurës së parë. Kolegji këto pretendime nuk i aprovoj pasi që vlerëson se pretendimet e paditësit kanë mbështetje në provat e administruara në këtë

çështje dhe në dispozitat materiale që e rregullojnë këtë çështje. Në bazë të provës pasqyra financiare është përcaktuar se investitori “Euro Projekt”, objekt ndërtesë kolektive, ku shuma totale për pagesë sipas bruto sipërfaqes në vlerë prej 104,469.28€, është paguar në emër të avansit 20,000.00€, totali i borxhit të mbetur 84,469.28€ dhe nga kjo pasqyrë shihet se dokumenti është i nënshkruar dhe i vulosur nga paditësi, mirëpo i pa nënshkruar dhe vulosur nga Komisioni Komunal dhe Komuna e Mitrovicës. Andaj, Dhoma e Shkallës së Dytë vlerësoi se e paditura nuk ka dëshmuar me prova konkrete që vërtetojnë faktin se Komuna e Mitrovicës ka aprovuar kërkesën e paditësit për rregullimin e tokës ndërtimore si dhe me një akt administrativ i ka përcaktuar tarifën për rregullimin e tokës ndërtimore, dhe në këtë mënyrë paditësi pa të drejtë dhe me një konkluzion absolutisht të pavlefshëm është ngarkuar për pagesën e shumës prej 84,469.28€.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata me rastin e nxjerrjes së aktgjykimit të atakuar nuk ka bërë konstatim të drejtë të gjendjes faktike dhe rrjedhimisht e njëjta ka zbatuar gabimisht dispozitën e Ligjit nr.02/L-28 për Procedurën Administrative, referuar si “Ligji për Procedurën Administrative” përkatësisht nenin 93 paragrafi 3, në rastin konkret gjykata nuk është dashur ta zbatoj fare këtë dispozitë për shkak se konkluzioni i nxjerrë nuk është nxjerrë në kundërshtim me asnjërin nga pikat e nenit 92 të Ligjit për Procedurën Administrative dhe rrjedhimisht nuk plotësohet asnjëri nga kushtet që konkluzioni të shpallet absolutisht i pavlefshëm. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së parë me rastin e vendosjes drejtë ka vendosur dhe drejtë aplikuar dispozitat ligjore në fuqi. Dhoma e Shkallës së Dytë pranon vlerësimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktgjykimi i atakuar me ankesë nuk është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 1 dhe 2 pika n), ku përcakton se: *“në qoftë se aktgjykimi ka të meta për shkak të të cilave nuk mund të ekzaminohet, e sidomos në qoftë se dispozitivi është i pakuptueshëm apo kontradiktor me vetvete ose me arsyet e aktgjykimit, apo nëse aktgjykimi nuk ka fare arsye apo në të janë treguar fare arsye për faktet vendimtare, ose ato arsye janë të paqarta, ose kontradiktore, ose nëse për faktet vendimtare ekzistojnë kundërthënie midis asaj që në arsyet e aktgjykimit – thuhet për përmbajtjen e dokumentit ose procesverbalit për thëniet e dhëna në procedurë dhe të vetë atyre dokumenteve ose të procesverbalit”* e as nenit 194 të LPK -së, të zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA -së, për të cilat Dhoma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare, po ashtu nuk është i përfshirë as në shkeljet e tjera të dispozitave të procedurës administrative e as me konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë në çështjen konkrete juridike në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, e cila nuk vihet në dyshim me pretendimet ankimore. Po ashtu pretendimet ankimore se vendimi është nxjerr në shkelje të dispozitave materiale të neneve 92, 93, 97, 98 dhe 99 të Ligjit për Procedurën Administrative dhe Nenit 184 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, kolegji i kësaj gjykate këtë pretendim nuk e aprovoi, pasi vlerësoi se aktgjykimi i kundërshtuar është i qartë dhe me elementet e nevojshme të arsytimit sipas nenit 48 të LPPA-së. Prandaj për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës dhe vërtetimit të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale, dhe Dhoma e Shkallës së Parë për vlerësimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara dhe bindëse faktike dhe juridike mbi faktet relevante për të vendosur në këtë

çështje juridike, të cilën në tërësi e aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë. Kolegji konstaton se Dhoma e Shkallës së Parë përfundimin e tërë kësaj procedure e ka arsyetuar në masë të mjaftueshme sa i përket rrethanave që kanë ndikuar në aprovimin e padisë. Përfundimisht, kolegji i kësaj gjykate i ka vlerësuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara në ankesë, por nuk ka gjetur se ekziston ndonjë shkelje e cila do të ndikonte që vendimi të kualifikohet si i tillë për çka çështja pastaj do të duhej të kthehej në rishqyrtim apo të vendoset ndryshe.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë,
K.DH.SH.II.nr.1526/23, me datë 16.04.2024

Kryetar i kolegjit,
Faton Bajrami